



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 13.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Biti Com" për aktivitetin: "Furnizimi me drunje dekorativ" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-3131-121 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Biti Com" e datës 11.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me drunje dekorativ" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-3131-121, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 07.08.2020*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 07.08.2020;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Biti Com**" me datë 11.08.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me drunje dekorativ" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3131-121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore lidhur me cmimet jonormalisht të ulta janë të pa bazuara, pasi që sipas rregullave për tenderet jonormalisht kushti i trete për të trajtuar një tender me çmim jonormalisht të ulët është që të pranohen së paku tre tender të përgjegjshëm, ndërsa në rastin e këtij aktiviteti kemi vetëm dy tender të përgjegjshëm, pasi që tenderuesi i trete ka qenë i pa përgjegjshëm dhe është refuzuar tenderi i tij.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

